



Data: 29/07/2019

Ref.: 1356/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në nivel institucional.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Teknologji, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
 - Teknologji, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik
 - Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
 - Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik
 - Inxhinieri Ekonomike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik
 - Vendburimet e lëndëve të para minerale, MSc, 120 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik
 - Xehtari, BSc, 180 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik
 - Xehtari, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Obligohet Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. AKA ka organizuar katër vizita të ndara me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit. Vizita e parë është realizuar me 10.04.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Anca Prisacariu dhe Oana Sarbu, vizita e dytë është realizuar me datë 25.04.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Reiner Doluschitz dhe Joachim Muller, vizita e tretë është realizuar me datë 07.06.2019 me këtë përbërje: Magdalena Platis, ndërsa vizita e katërt është realizuar me datë 28.05.2019 me këtë përbërje: Regita Bendikiene dhe Bettie Higgs.

KShC në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapituj të standardeve të Manualit të Akreditimit, Universiteti i Mitrovicës plotëson pjesërisht 10 nga to (Deklarata e Misionit dhe Objektivat Institucionale; Planifikimi dhe menaxhimi financiar; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i Cilësisë; Mësimdhënia dhe Mësim marrja; Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional, Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe infrastruktura; Bashkëpunimi institucional) ndërsa nuk plotëson kapitullin e standardit për Planifikimin strategjik, qeverisjen dhe administrimin.

Sa i përket kapitullit të parë për deklaratën e misionit dhe objektivat institucionale, ekspertët kanë deklaruar se deklarata e misionit të Universitetit të Mitrovicës është deri në masën 53% identike me deklaratën e misionit e një universiteti tjetër publik. Rrjedhimisht ekspertët konsiderojnë se kjo çështje nuk është etike dhe se kjo çështje nuk duhet të konstatohet tek një universitet. Deklarata ekzistuese e misionit sipas ekspertëve nuk është plotësisht në përputhje me karakteristikat e një misionit i cili ofron menaxhim të duhur në vendimmarrjen e institucionit. Po ashtu ekspertët kanë vërejtur gjatë vizitës se anëtarët e komunitetit akademik të universitetit nuk kanë qenë në dijeni për misionin e universitetit dhe se nuk është e qartë se deri në cilën masë deklarata e misionit ofron udhëzime të qarta për planifikim strategjik, vendimmarrje dhe aktivitetet e universitetit. Ani pse universiteti ka deklaruar se është krijuar një grup për rishikimin e deklaratës së misionit, ekspertët kanë deklaruar se nuk kanë gjetur dëshmi që procesi i konsultimit ka përfshirë edhe akterë të jashtëm.

Sa i përket kapitullit për planifikim strategjik, ekspertët kanë konstatuar se procesi i konsultimit të jashtëm për strategji nuk ka përfshirë studentë, përfaqësues të punëdhënësve apo tregut të punës. Ani pse plani strategjik ka një planifikim buxhetor, ekspertët kanë deklaruar se jo ato nuk përfshihen në të gjitha rastet ku duhet të ketë impakt buxhetor. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se planifikimi strategjik nuk është i përfshirë në proceset e lidhura me buxhetin, dhe se prioritetet financiare të cilat i janë vënë në dispozicion Ekspertëve, nuk janë të njëjta me prioritetet e përfshira në planin strategjik. Qëllimet strategjike të planit nuk janë vendosur në një formë kalendarike dhe se gjitha prej tyre ka një afat kohor "2018 dhe vazhdim" apo "2018-2021" duke i pamundësuar kështu ekspertëve të dinë se si universiteti i vendos prioritetet e veta gjatë një periudhe të specifikuar kohore. Sipas ekspertëve plani strategjik nuk ka masa të matshme, targete apo indikatorë të performancës dhe kjo i ka pamundësuar atyre të vlerësojnë nëse universiteti arrin të vlerësojë progresin e veprimeve të tij dhe nëse ato qëllime strategjike janë duke shkuar në drejtimin e duhur. Përpos planit strategjik, ekspertët kanë vërejtur se organogrami i universitetit i përfshirë në RVV nuk është i njëjti me atë të përfshirë në Statutin e universitetit. Duke pasur parasysh këtë kontradiktë, ekspertët nuk kanë arritur të konstatojnë nëse përgjegjësitë e strukturave qeverisëse janë të përcaktuara në atë mënyrë që rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për politikën e përgjithshme janë të përcaktuara qartë dhe implementohen në praktikë. Ekspertët nuk kanë arritur të identifikojnë asnjë student si pjesëmarrës në asnjë prej trupave vendimmarrëse, ekzekutive dhe konsultative të universitetit. Sipas ekspertëve, në kohën e vizitës në institucion, institucioni nuk kishte staf të plotë në administratë prandaj ekspertët janë shqetësuar në lidhje me atë se si menaxhmenti i përgjigjet nevojave institucionale në mënyrë që të sigurohet se administrata është efektive në drejtim të organizimit dhe funksionalitetit.

Sa i përket planifikimit financiar ekspertët kanë deklaruar se universiteti nuk ka ofruar informacione apo analiza të mjaftueshme për projektet e ardhshme sa i përket zhvillimit të stafit dhe hulumtimit, bursave apo mbështetjes që i ofrohet për student. Ani pse universiteti ka një buxhet vjetor dhe buxhet tre vjeçar, ekspertët kanë konsideruar se është shqetësuese qëndrueshmëria financiare e institucionit.

Sa i përket integritetit akademik, ekspertët kanë deklaruar se ekziston një Kod i Etikës i cili nuk është i publikuar në ueb faqen e institucionit, dhe se ekspertët konsiderojnë se ky Kod duhet të jetë më specifik, më transparent dhe i parashikueshëm sa i përket vendimeve që mund të merr. Ekspertët nuk kanë pranuar përgjigje kur kanë pyetur universitetin sa i përket rregulloreve për sjellje jo të mirë akademike, plagjiarizmin apo kopjimin, dhe se shumica e stafit me të cilët ekspertët janë takuar nuk kanë qenë të vetëdijshëm për ekzistimin e një Kodi të Etikës i cili rregullon këto fusha. Përfundimisht, ekspertët kanë konkluduar se proceset dhe mekanizmat e dedikuara për zbatimin e normave dhe vlerave etike në universitet nuk janë të qarta dhe transparente mjaftueshëm.

Sa i përket sigurimit të cilësisë, ekspertët ndër të tjera kanë deklaruar se, pavarësisht aprovimit të një rregullore për sigurim të cilësisë, e njëjta nuk është implementuar edhe pas një viti nga aprovimi i rregullores. Funksionet e sigurimit të cilësisë në të gjithë institucionin nuk janë integruar në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit dhe se të intervistuarit që ekspertët kanë takuar kishin vështirësi të tregojnë shembujt e ndryshimeve në bazë të të dhënave të mbledhura nga sistemi i sigurimit të cilësisë. Sipas ekspertëve pavarësisht se parashihen disa mekanizma për mbledhjen

e të dhënave, megjithatë, asnjë nga ato praktika nuk u konfirmua gjatë vizitës në terren; në vend të kësaj, ekspertët kanë konstatuar se funksionet e sigurimit të cilësisë nuk janë të integruara në planifikimin normal dhe zhvillimin e strategjive të universitetit dhe se sistemi i sigurimit të cilësisë nuk ka ndonjë kontribut në monitorimin e arritjeve dhe objektivave strategjike.

Sa i përket kapitullit për mësimdhënie dhe mësim marrje, ndër të tjera, ekspertët kanë deklaruar se pavarësisht ekzistimit të disa rregulloreve, nuk ekziston një instrument formal për sigurimin e cilësisë përveç vlerësimit të lëndëve të bëra nga studentët. Cilësia e mësimdhënies dhe efektiviteti i programeve sipas ekspertëve nuk vlerësohen përmes të diplomuarve dhe pyetësorëve të punëdhënësve. Në përgjithësi, metodat e të mësuarit konsiderohen të përqendruara tek studenti dhe nxisin mësim marrjen e studentëve, sidoqoftë, ekspertët nuk kanë identifikuar, në dokumentacionin e universitetit apo gjatë vizita në terren, metodat inovative të mësimdhënies që përfshijnë studentët si pjesëmarrës aktivë në mësimin e tyre, shtigjet fleksibël të mësimin dhe rrugët alternative të aksesit, duke përfshirë njohjen e të mësuarit paraprak.

Sa i përket kapitullit të Hulumtimit, universiteti përmes RVV-së kishte deklaruar se ekziston një Plan i Hulumtimit i cili nuk është ofruar si dokumentacion plotësues dhe se nga personat me të cilët është takuar ekipi i ekspertëve është konstatuar se një plan i tillë nuk ekziston në Universitetin e Mitrovicës dhe se vetëm tani është duke u punuar në të. Ani pse universiteti ka deklaruar disa parime sa i përket hulumtimit, ekspertët nuk kanë pasur asnjë dëshmi për implementimin e vërtetë të tyre duke pasur parasysh mungesën e një Plani për Zhvillimin e Hulumtimit dhe se RVV nuk sqaron se cila janë këto objektiva të hulumtimit të institucionit apo prioritete në fushën e hulumtimit. Sipas RVV-së, institucioni inkurajon krijimin dhe aktivitetin e grupeve kërkimore, të strukturuar rreth profesorëve dhe asistentëve brenda departamentit, dhe bashkëpunimin midis departamenteve, në varësi të natyrës së kërkimit shkencor. Megjithatë, ekspertët konsiderojnë se ky deklarim është i pambështetur nga dëshmitë për arsye se: ekziston një kulturë shumë e pazhvilluar e kërkimit në të gjithë institucionin, prodhimi dhe vlefshmëria e hulumtimit është zvogëluar, buxheti është i kufizuar dhe kjo është pranuar në RVV, ka sfida të stafit akademik që vazhdon të shohë rolin e tyre si profesor, stafi nuk ka vullnet për t'u botuar në revista me kritere të larta për botim dhe menaxhimi i institucionit nuk është duke punuar së bashku për të nxitur më shumë punën kërkimore.

Sa i përket kapitullit për punësimin e stafit akademik, ekspertët kanë deklaruar se politikat dhe procedurat e stafit nuk janë të centralizuara në formën e një doracaku për punësim dhe i cili bëhet i disponueshëm për stafin gjatë periudhës së tyre të punësimit. Kandidatët për punësim nuk pajisen me përshkrime të plota të pozitës dhe kushtet e punësimit. Po ashtu, ekspertët kanë deklaruar se Institucioni nuk ka zhvilluar një politikë / procedurë të rishikimit të performancës së stafit që pasqyron të gjitha instrumentet e dedikuara për vlerësimin e secilës kategori të stafit, ndikimi i secilit instrument që ka në rezultatin e përgjithshëm vjetor dhe ndikimin e tyre në avancim, rritjen e pagës, etj. Ani pse universiteti ka hartuar një plan për zhvillimin e stafit, ekspertët nuk kanë arritur të vlerësojnë zbatimin e tij; megjithatë, kanë kuptuar që nuk janë caktuar caqe të matshme dhe asnjë buxhet nuk është ndarë për zbatimin e planit. Kur ekspertët kanë pyetën për prioritetet e zhvillimit të stafit, përfaqësuesit e institucionit kanë deklaruar se këto përdoren vetëm në lidhje me proceset e avancimit të stafit.

Sa i përket administrimit të studentëve dhe shërbimeve mbështetëse, ekspertët kanë deklaruar se jo gjitha informatat janë të publikuara në ueb faqe për pranimin e studentëve të rinj. Po ashtu sipas ekspertëve menaxhimi i të dhënave për studentët është i pakët dhe i pashfrytëzuar: universiteti nuk mbledhë të dhëna mbi profilin e popullsisë studentore, arsyet për braktisjen ose shtigjet e karrierës së të diplomuarve. Institucioni administron të dhënat për progresin dhe suksesin e studentëve, numrat e braktisjes dhe kënaqshmërinë e studentëve me programet e tyre, burimet e të mësuarit administrimin dhe shërbimet mbështetëse. Mirëpo pyetjet e përfshira në pyetësorin e studentëve i referohet shërbimeve që aktualisht nuk ofrohen nga institucioni ose janë shumë të përgjithshme për të siguruar detajet e nevojshme për të shërbyer si bazë për përmirësim. Ne te gjitha rastet, ekspertët kanë deklaruar se nuk ka përdorim koherent të të dhënave as për të mbështetur vendimmarrjen, as sistemin e sigurimit të cilësisë.

Sa i përket kapitullit për hapësirat dhe infrastrukturën, ekspertët kanë deklaruar se nuk kanë arritur të vlerësojnë burimet e literaturës dhe librat meqenëse në kohën e vlerësimit biblioteka nuk ishte në dispozicion për studentët. Sipas ekspertëve, studentët kanë pasur qasje të kufizuar në bibliotekë për 6 muajt e fundit. Sipas tyre, stafit dhe studentëve u jepet mundësia për të përdorur bibliotekën publike të qytetit gjatë tërë kohës kur biblioteka institucionale nuk ka qenë funksionale. Po ashtu, pajisjet kompjuterike, sistemet dhe softueri i përdorur në proceset arsimore nuk azhurnohen sipas punës dhe nevojave të tregut, veçanërisht në fushën e TI-së. Gjithashtu, stafi nuk ka softuerë të mjaftueshme për punë kërkimore dhe se laboratorë hulumtues për shkencat shoqërore duhet të vihen në dispozicion. Universiteti nuk ka hapësira rekreative, kafene, objekte sportive, mjekësore dhe nuk ofron akomodim për studentët e tij. Ekspertët kanë deklaruar se proceset e sigurimit të cilësisë të përdorura për të vlerësuar kënaqësinë e studentëve me burimet e mësimit dhe infrastrukturën nuk janë të përshtatshme; siç shpjegohet edhe më sipër, pyetjet e pyetësorit i referohen shërbimeve që institucioni nuk ofron aktualisht ose pyetjet janë shumë të përgjithshme për të siguruar detajet e nevojshme për të shërbyer si bazë për përmirësim. Sipas eksperteve, asnjë instrument ekuivalent nuk është në vend për të mbledhur vlerësimin e profesorëve me burimet e mësimit dhe lehtësitë.

Sa i përket bashkëpunimit institucional, ekspertët kanë deklaruar se universiteti nuk ka strategji apo politikë për këtë fushë. Ky portofol i punës i është caktuar zëvendës-reaktorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe Zhvillim të Cilësisë, një anëtar i lartë i menaxhmentit që ka mandat të drejtpërdrejtë dhe është përgjegjës për iniciativat dhe rezultatet në këtë fushë. Përkundër këmbënguljes së përsëritur, ekspertët nuk kishin arritur ta takonin këtë person, dhe arsyet për mungesën e tij ishin konfuzë dhe kontradiktore. Ani pse universiteti ka prezantuar një numër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, ekspertët kanë deklaruar se shumica e tyre janë jo aktive. Bazuar në diskutimet gjatë vizitës në terren, ekspertët kanë mësuar se stafi nuk është i mjaftueshëm inkurajuar të marrë pjesë në forume në të cilat diskutohen çështje të rëndësishme të komunitetit apo aty ku konsiderohen planet për zhvillimin e komunitetit. Sipas ekspertëve, ka pak dëshmi për angazhimin e punëdhënësve lokal dhe profesionistëve në punën e komisioneve të programeve të studimit të universitetit. Rrjedhimisht, sipas tyre nuk ka komunikim sistematik të universitetit për të konsultuar industrinë në regjion për kërkesat e tyre në lidhje me të diplomuarit e Universitetit. Ekspertët kanë identifikuar një eksplorim të kufizuar të mundësive aktuale të ndërkombëtarizimit për universitetin dhe se rekomandon ata që ndërkombëtarizimi të mos zhvillohet në baza të iniciativave individuale të stafit mirëpo të ketë një angazhim institucional dhe të ofrohet


mbështetje për e madhe për te promovuar aktivitetet që qojnë në ndërkombëtarizmin e universitetit. Duke u bazuar në gjetjen e ekspertëve si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se programet e studimit të cekura më sipër përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e riakreditimit. Megjithatë, duke pasur parasysh Nenin 15, paragrafin 6, të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011, i cili përcakton se *“Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë nuk arrin të fitojë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me një organizim tjetër të akreditimit jo më vonë se pas një viti”* dhe paragrafin 7 i cili përcakton se *“Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës, bartësi mund të ankohet në organin kompetent konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ”*, Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” i ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj në programet e studimit me akreditim valid për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional, sipas dispozitave të cekura më sipër. Studentët e regjistruar në programet e studimit para marrjes së vendimit për mos riakreditim institucional, vazhdojnë studimet e tyre në përputhje me statutin e institucionit si dhe me dispozitat e tjera në fuqi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

